



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS**

**MIRATOHET
MINISTRI**

Luan MEMUSHI

PROGRAMI I LËNDËS

SË MATEMATIKËS

KLASA III

CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9 - VJEÇARE

Tiranë, 2005

1. Të përgjithshme

- Mësimi i matematikës në klasën e tretë të arsimit të detyruar zhvillohet në:

35 javë mësimore me 5 orë në javë

Gjithsej: 35 javë x 5 orë/javë= 175 orë vjetore

- 14%-20% e kohës mësimore (25-35 orë) lihet në dispozicion të mësuesit dhe mund të përdoret prej tij për përsëritje, kontrolle (testime) ose për qëllime të tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor.
- Hartimi i programit të matematikës për klasën e tretë është bazuar në programet e klasave paraardhëse, programet e mëparshme të matematikës dhe modele bashkëkohore të vendeve të tjera.

2. Synimi

Programi i matematikës për klasën e tretë dhe zbatimi i tij zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë e marra në dy klasat e para, forcojnë bazën mbi të cilën ndërtohet mësimi i matematikës dhe formojnë shprehitë matematike që përdoren në vazhdimësi jo vetëm gjatë periudhës shkollore, por edhe në situata të ndryshme të jetës së përditshme. Nëpërmjet parashtrimeve në vijim synohet zhvillimi i aftësisë për të vrojtuar, për të shpjeguar, për të nxjerrë përfundime, për të argumentuar.

Programi është i konceptuar nëpërmjet linjave dhe nënlinjave të përmbajtjes, të cilat përshkojnë të gjithë kursin e matematikës në arsimin e detyruar.

3. Linjat e nënlinjat kryesore

Programi i paraqitur në vijim, është i konceptuar sipas linjave dhe nënlinjave të përmbajtjes:

1. Numri

- 1.1. Kuptimi i numrit
- 1.2. Veprime me numra

2. Matja

- 2.1. Kuptimi dhe përdorimi i matjes
- 2.2. Njehsimi i gjatësisë, perimetrit, sipërfaqes dhe vëllimit

3. Gjeometria

- 3.1. Gjeometria në plan
- 3.2. Gjeometria në hapësirë
- 3.3. Shndërrimet gjeometrike dhe rrjeti koordinativ

4. Algjebra dhe funksioni

- 4.1. Kuptimi i shprehjeve shkronjore
- 4.2. Shndërrime të shprehjeve shkronjore
- 4.3. Zgjidhja e ekuacioneve, inekuacioneve
- 4.4. Funksioni

5. Mbledhja, organizimi dhe përpunimi i të dhënave; probabiliteti

- 5.1. Statistikë
- 5.2. Probabilitet

Shënim. Lista dhe emërtimi i linjave e nënlinjave parapëlqehet të ruhen deri në fund të arsimit të detyruar. Si pasojë, duke respektuar uniformitetin e sasisë dhe të terminologjisë, në programet gjatë viteve të para të zbatimit për ndonjë prej linjave apo nënlinjave mund të ndodhë që, në përgjigje të veçorive moshore, kuptimi i emërtimit të linjës/nënlinjës të jetë më i gjerë se konceptet që përfshihen në të ose nënlinja të mos shtjellohet.

4. Objektivat, konceptet e shprehite kryesore sipas linjave e nënlinjave

Synimi i programit të matematikës për klasën e tretë mishërohet në objektiva të detyrueshëm për secilën linjë apo nënlinjë. Në përputhje me objektivat, janë përcaktuar edhe konceptet e shprehite përkatëse.

4.1. Numri

Kuptimi i numrit

Objektivat

Nxënësit të jenë të aftë:

- *Të përdorin, të lexojnë, të shkruajnë dhe të numërojnë numra natyrorë deri në 10000, duke kuptuar lidhjen e vendit të çdo shifre me vlerën e saj.*
- *Të përdorin kuptimin e numrit natyror për të krahasuar numra deri në 10000.*
- *Të lexojnë, të shkruajnë dhe të përdorin kuptimin e numrit thyesor në situata konkrete.*
- *Të gjejnë pjesën e një numri me anë të njësisve thyesore ($1/2$, $1/3$, $1/4$ etj.)*
- *Të krahasojnë thyesa të thjeshta, duke përdorur interpretime konkrete.*

Konceptet dhe shprehite kryesore

Koncepti i numrit deri në 10000; interpretime të ndryshme të numrit (diagrami i Venit); numri dhe numërori; shkrimi i numrave deri në 10000; koncepti i numrit rreshtor; numërimi me nga 2, 5, 10, 20 etj.; krahasimi dhe radhitja e numrave; mosbarazimet dhe përdorimi i simbolikës përkatëse; thyesa të thjeshta dhe krahasimi i tyre nëpërmjet interpretimeve konkrete (p.sh., boshti numerik); gjetja e $1/2$; $1/3$; $1/4$, etj të një numri.

Veprimet me numra

Objektivat

Nxënësit të jenë të aftë:

- *Të mbledhin e të zbresin me mend një numër dyshifror me një numër njëshifror me shumë deri në 100.*
- *Të mbledhin me shkrim numra natyrorë me shumë deri më 10000.*
- *Të zbresin me shkrim dy numra natyrorë deri në 10000.*
- *Të shumëzojnë me mend deri në 10×10 .*
- *Të shumëzojnë me shkrim, me prodhim deri në 10000, një numër natyror dy-ose-treshifror me një numër natyror një shifror*
- *Të shumëzojnë me shkrim, me prodhim deri në 10000, numra natyrorë me dhjetëshe të plota.*
- *Të pjesëtojnë një numër natyror deri në 100 me një numër natyror jo më të madh se 10 dhe pa mbetje.*

- Të mbledhin e të zbresin thyesa të thjeshta me emërues të njëjtë.
- Të zbatojnë mënyra të ndryshme njehsimi duke përdorur edhe vetitë e veprimeve.
- Të përdorin kuptimin e mbledhjes, të zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit (në bashkësinë përkatëse të numrave) në situata problemore të jetës së përditshme (në mjedise të njohura për nxënësit), të simuluar ose jo, që zgjidhen me jo më shumë se tri veprime.

Konceptet dhe shprehjet kryesore

Mbledhje dhe zbritje me mend deri në 100 të formës $65+4$; $65+8$; $65-4$; $65-8$; mbledhje e zbritje me shkrim deri në 10000 me kalim e prishje të dhjetëshes, të qindëshes ose të mijëshes; shumëzime me mend (9×7); shumëzime të formës 45×8 ; 987×9 ; shumëzime të formës 20×230 ; pjesëtime të formës $63:9$; $84:7$; mbledhje e zbritje thyesash $1/3+2/3$; $4/5-2/5$.

Matja

Objektivat

Nxënësit të jenë të aftë:

- Të matin, me përafërsi, gjatësitë duke përdorur si njësi standarde mm, cm, m.
- Të krahasojnë gjatësitë e segmenteve (duke përdorur edhe kompasin).
- Të matim me përafërsi, nëpërmjet mbulimit (me numërim) sipërfaqen e figurave duke përdorur:
njësi jostandarde: (trekëndësha, paralelograme etj.)
njësi standarde: centimetrin katror.
- Të matin me përafërsi nëpërmjet mbushjes vëllimin e trupave duke përdorur:
njësi jostandarde (trupa me masë të njëjtë)
njësi standarde: centimetrin kub
- Të gjejnë masën e sendeve (me anë të balancës) duke përdorur:
njësi jostandarde (trupa me masë të njëjtë)
njësi standarde (kilogramin, gramin)
- Të matin kohën duke përdorur njësitë: minutë (në pesëminutshin më të afërt), orë, ditë, muaj, vit
- Të këmbëjnë njësitë e njohura emërore të gjatësisë, masës, kohës e të kryejnë veprime të thjeshta me to.
- Të këmbëjnë monedha e kartmonedha e të kryejnë veprime me to.
- Të zgjidhin probleme të thjeshta me matje në situata nga jeta e përditshme.
- Të njehsojnë gjatësinë e vijës së thyer (përfshirë perimetrin e trekëndëshit e katërkëndëshit)
- Të bëjnë parashikime të thjeshta paraprake përpërfundimin e një matjeje.

Konceptet dhe shprehjet kryesore

Përdorimi i njësive jostandarde rrethore; njësitë standarde: cm, m, mm, ora, minuta, dita, muaji, viti, gr, kg. Monedhat. Këmbime dhe veprime me njësite (p.sh., $1\text{kg } 300\text{gr} + 2\text{kg } 200\text{ gr}$). Zgjidhje problemash me matje të drejtpërdrejta ose të përfytyruara.

4.3. Gjeometria

Gjeometria në plan

Objektivat

Nxënësit të jenë të aftë:

- *Të dallojnë dhe të emërtojnë figura gjeometrike dhe elemente të tyre.*
- *Të përshkruajnë figurat gjeometrike duke përmendur veti të elementeve të tyre.*
- *Të vizatojnë segmente me gjatësi të dhënë.*
- *Të vizatojnë këndin e drejtë dhe rrethin me veglat përkatëse.*
- *Të dallojnë, të emërtojnë dhe të vizatojnë me sy drejtëza paralele, drejtëza pingule, drejtëza që priten.*

Gjeometria në hapësirë

Objektivat

Nxënësit të jenë të aftë:

- *Të dallojnë dhe të emërtojnë trupa gjeometrikë dhe elemente të tyre.*
- *Të përshkruajnë trupa gjeometrikë duke përmendur veti të thjeshta të tyre (numri i brinjëve, i faqeve etj.).*
- *Të ndërtojnë trupa gjeometrikë (me plasteline dhe sipas hapjeve të gatshme).*

Shndërrimet gjeometrike dhe rrjeti koordinativ

Objektivat

Nxënësit të jenë të aftë:

- *Të gjejnë dhe të vizatojnë drejtëzën e simetrisë së figurave të thjeshta.*
- *Të vizatojnë simetrikën e një figure sipas një drejtëze në rrjetin e katrorëve.*
- *Të përshkruajnë vendndodhjen në situata reale duke përdorur fjalë të jetës së përditshme.*
- *Të përshkruajnë, me anë të koordinatave, vendndodhjen e një pike në rrjetin koordinativ*
- *Të përshkruajnë kalimin nga një pikë e rrjetit koordinativ në një tjetër.*
- *Të vizatojnë figura të thjeshta gjeometrike në rrjet katror.*
- *Të zmadhojnë ose të zvogëlojnë një figurë të thjeshtë në rrjetin koordinativ.*

Konceptet dhe shprehjet kryesore (për të tria nënlinjat)

Trupa dhe figura gjeometrike. Vizatimi i figurave gjeometrike në rrjet koordinativ.

Drejtëza e simetrisë; vizatimi i figurës simetrike të një figure të dhënë në lidhje me një drejtëz simetrie në rrjet koordinativ. Koordinatat e një pike në rrjet.

Vendndodhja afër dhe larg duke përdorur termat: drejt, para, pas, mbi, nën, majtas, djathtas. Zmadhimi ose zvogëlimi i një figure të thjeshtë në rrjetin koordinativ.

4.4. Algjebra

Objektivat

Nxënësit të jenë të aftë:

- *Të plotësojnë çiftime të thjeshta ndërmjet grupeve, me diagram shigjetor apo me tabelë.*
- *Të shënojnë elementin e ri (numër natyror) sipas një operatori ose dy operatorëve të njëpasnjëshëm.*
- *Të përdorin kutizën, si vendmbajtëse e numrit natyror.*
- *Të zgjidhin ekuacione dhe inekuacione të thjeshta me tentativë, duke përdorur mbledhje, zbritje, shumëzim ose pjesëtim (në bashkësinë përkatëse të numrave).*
- *Të zbulojnë ligjësi të thjeshta dhe të plotësojnë modele sipas një ligjësie.*

Konceptet dhe shprehjet kryesore

Çiftimi sipas një cilësie, radhitja sipas një cilësie; përdorimi i operatorit; zgjidhje ekuacionesh dhe inekuacionesh të thjeshta duke përdorur 4 veprimet, veç e veç, në bashkësinë e numrave në të cilat veprimi është shqyrtuar në linjën e numrit, pa kërkuar shkathësi të mirçfilltë.

4.5. Mbledhja, organizimi dhe përpunimi i të dhënave; probabiliteti

Objektivat

Nxënësit të jenë të aftë:

- *Të dallojnë që një objekt mund të ketë më shumë se një cilësi dhe të klasifikojnë objekte në bazë të jo më shumë se dy cilësive të tyre*
- *Të interpretojnë tabela të gatshme të thjeshta ose diagrame të thjeshta me të dhëna të njohura nga jeta e përditshme.*
- *Të mbledhin e të klasifikojnë të dhëna nga mjedisi i tyre*
- *Të hetojnë situata të thjeshta probabilitare në të cilat një ngjarje mund të ndodhë ose jo.*
- *Të përdorin gjuhën matematike në situata joformale për të përshkruar probabilitetin.*

Konceptet dhe shprehjet kryesore

Zbulimi i cilësive të përbashkëta të një grupi sendesh, klasifikimi i një grupi objektesh sipas cilësive të përbashkëta (jo më shumë se dy); mbledhja e të dhënave nga mjedise të njohura dhe klasifikimi e diskutimi rreth tyre; interpretimi i tabelave dhe diagrameve të gatshme.

Lojëra dhe eksperimente të thjeshta që lejojnë të gjykohet nëse një ngjarje mund të ndodhë ose jo; përdorimi i shprehjeve: ka mundësi, nuk ka mundësi, mbase ose i të tjerave të ngjashme me to.

5. Programi analitik

Në vitin e tretë të arsimit të detyruar 9-vjeçar, matematika do të zhvillohet në 35 javë mësimore me 5 orë në javë.

$$35 \text{ javë} \times 5 \text{ orë/javë} = 175 \text{ orë}$$

| Linjat dhe nënlinjat | Sasia e orëve |
|---|---------------|
| Numri | 92 |
| Kuptimi i numrit | 30 |
| Veprimet me numra | 62 |
| Matja | 20 |
| Kuptimi dhe përdorimi i matjes | 10 |
| Njehsimi i gjatësisë, perimetrit, sipërfaqes dhe vëllimit | 10 |
| Gjeometria | 20 |
| Gjeometria në plan | 6 |
| Gjeometria në hapësirë | 8 |
| Shndërrimet gjeometrike | 8 |
| Algjebra dhe funksioni | 8 |
| Mbledhja, organizimi dhe përpunimi i të dhënave; probabiliteti | 10 |
| Statistikë | 7 |
| Probabilitet | 3 |
| Orë të lira | 25 |

Shënim. Gjatë shtjellimit linear të lëndës (që mishërohet në tekst) konceptet e secilës linjë apo nënlinjë nderthurren me ato të linjave e nënlinjave të tjera dhe mund të zënë vend aty ku e kërkon trajtimi sa më i qartë i një koncepti të ri në përputhje me objektivat e detyrueshëm.

6. Metodologjia e zbatimit të programit

Realizimi i programit në tekstin bazë, në fletë pune, në materiale të tjera ndihmëse, në procedimin e orës së mësim, në hartimin e testeve, në përzgjedhjen e mjeteve mësimore kërkon që:

- Zbatimi i tij të bazohet në parimin spiral. Konceptet kryesore të shtrihen pothuajse gjatë të gjithë lëndës dhe nxënësi të punojë me to për një kohë të gjatë duke i rimarrë. Kjo bëhet për shkak të domosdoshmërisë që kanë trajtimet matematike për t'u bazuar në konceptet kryesore, si dhe për të siguruar një përvetësim sa më të plotë të tyre nga nxënësit.
- Dhënia e koncepteve të bëhet kryesisht në mënyrë intuitive dhe të ketë për bazë një veprimtari konkrete.
- Një rëndësi e veçantë t'u kushtohet problemave, shumëllojshmërisë së strategjive për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë edhe situata hetimesh të thjeshta me veshje jomatematike ku përpunohen elemente fillestare të euristikës.

- Për zotërimin e koncepteve, t'i jepet rëndësi larmisë së rrugëve për të arritur tek ato. Po ashtu edhe larmisë së interpretimeve dhe zbatimeve të tyre.
- Konceptet e shprehita të ngrihen mbi përvojën reale të nxënësve dhe përmes situatave reale. Zhvillimi i koncepteve t'i drejtohet mjedisit të nxënësit, përvojës së tij të përditshme, duke përfshirë edhe lojën si element didaktik të përshtashëm për nxënësit e klasës së tretë.
- Larmia e detyrave të jetë e tillë që t'i japë mundësi çdo nxënësi të gëzojë suksesin e tij në matematikë.
- Realizimi i lidhjes ndërlëndore nëpërmjet bashkërendimit të veprimtarive në lëndë të tjera me veprimtaritë në mësimin e matematikës të jetë në vëmendje të zbatuesit.
- Për zbatimin e programit të përdoren mjete individuale konkrete të nxënësit, si dhe mjete demonstrative, në varësi të trajtimeve që do t'i bëhen koncepteve në tekstin e nxënësit.
- Për të plotësuar nevojat dhe interesat e nxënësve, mund të përdoren edhe materiale ndihmëse, të cilat plotësojnë kriteret dhe ndihmojnë në arritjen e objektivave.

Realizimi i programit të matematikës do të mbështetet në dokumentacionin bazë të miratuar nga instancat përkatëse.

7. Metoda e mësimdhënies

Realizimi i programit të matematikës i jep përparësi zhvillimit të të menduarit të pavarur e krijues të nxënësve. Mësuesi e drejton dhe e ndihmon nxënësin që punon kryesisht në mënyrë të pavarur.

Gjatë mësimdhënies, formimi i konceptit të jetë një proces i natyrshëm ku mbizotëron veprimtaria e nxënësve, si dhe njohuritë e shprehita të zhvillohen në mendjen e tyre kryesisht si një proces zbulimi vetjak, më vete apo në punë grupi.

Në mësimin e matematikës, synohet që nxënësi të ndihet i lirë të pyesë, të gabojë, të qortohet dhe të qortojë.

Përdorimi i mjeteve mësimore të jetë rrjedhojë e një procesi të menduar mirë në mënyrë që t'i shërbejë arritjes së objektivave të paravendosur.

Për një mësimdhënie më efektive mund të përdoren edhe materiale ndihmëse, të cilat ndihmojnë arritjen e objektivave të linjave.

Një mësimdhënie e suksesshme është faktor vendimtar në formimin e qëndrimit pozitiv ndaj matematikës si lëndë shkollore.

8. Komponentë kryesore të mëimit të matematikës

Komponentë kyç të mëimit të matematikës, në përgjithësi, dhe në klasën e tretë, në veçanti, janë: zgjidhja e problemave, komunikimi, arsyetimi dhe lidhjet konceptuale.

Zgjidhja e problemave

Zgjidhja e problemave të jetë në qendër të mëimit të matematikës. Është procesi nëpërmjet të cilit nxënësit kuptojnë dhe ndiejnë fuqinë e matematikës në botën që i rrethon. Zgjidhja e problemave, e cila është pjesë e qëndrueshme e secilës nga linjat, është e nevojshme t'u ofrohet nxënësve në sa më shumë mënyra.

Në klasën e tretë zgjidhja e problemave fillon e bazohet jo vetëm në situata konkrete, empirike, jolibreske, por edhe në situata të simuluar duke mos harruar përdorimin e elementit lojë. Nxënësit fillojnë të dallojnë ekzistencën e më shumë se një zgjidhjeje, të bëjnë pyetje për botën që i rrethon dhe të përpiqen të gjejnë përgjigje për pyetjet e bëra.

Komunikimi matematik

Matematika është një gjuhë, e cila merr kuptim te nxënësit nëse ata fillojnë të komunikojnë (me shkrim ose me gojë) konceptet matematike dhe të zbatojnë njohuritë matematike në mënyrë efektive. Gjuha e jetës së përditshme është një urë që lidh informalen dhe intuitiven me simbolikën matematike.

Në klasën e tretë simbolika e komunikimit matematik është e kufizuar. Kjo për t'iu përshtatur veçorive psikologjike të moshës, në veçanti shkallës së zhvillimit të proceseve të të menduarit. Në shërbim të konceptit matematik shpesh përdoret edhe gjuha informale e veshur me kontekstin matematik.

Nxitja e nxënësve për të përshkruar situata, zgjidhje, vrojtime, hulumtime me fjalët e përshtatshme (por ende jospecifike), për të plotësuar tabela, diagrame, ndikon pozitivisht në zhvillimin e shprehive komunikuese.

Arsyetimi

Arsyetimi është themelor në mësimin e matematikës. Pavarësia e çdo individi zhvillohet nëpërmjet ndërveprimet të tij për të arsyetuar në mënyrë logjike dhe për të argumentuar mendimin e tij. Klima që krijohet në klasë me nxitjen e mendimit kritik e krijues dhe të diskutimeve të lira gjatë zgjidhjes së problemave, të jetë në qendër të mësimin të matematikës.

Në klasën e tretë nxënësi fillon të kuptojë analogjitë dhe ndryshimet, të ndjekë hapat e nevojshëm në një proces kërkimi, të kushtojë vëmendje ndaj saktësisë. Gjithsesi, arsyetimi vazhdon të mbështetet kryesisht në një kontekst kryesisht konkret e fizik.

Lidhjet konceptuale

Gjatë mësimin të matematikës nxënësit kanë nevojë të kuptojnë që konceptet matematike lidhen me njëri-tjetrin, me lëndët e tjera dhe me situata të jetës së përditshme.

Për këtë qëllim, linjat e përmbajtjes nuk duhen trajtuar të izoluara, por të ndërthurura me njëra-tjetrën, për të dhënë idenë e matematikës si një e tërë.

Përdorimi i matematikës në lëndë të tjera dhe anasjellas, si dhe marrja e zbatimeve nga situata reale i ndihmon nxënësit ta quajnë matematikën si një mjet të fuqishëm e fleksibël për të kuptuar e për të jetuar botën që i rrethon.

9. Vlerësimi

Vlerësimi është një proces, i cili jep informacion të domosdoshëm e të mjaftueshëm për të verifikuar e për të matur përvetësimin e koncepteve e të shprehive nga nxënësit.

Planifikimi i punës së mëtejshme bazohet thelbësisht mbi këtë informacion.

Vlerësimi bazohet mbi objektivat e paravendosur, duke filluar që nga objektivat vjetorë e deri te objektivat e vendosur për një grup njësisht mësimore apo për një njësi mësimore të caktuar.

Në klasën e tretë fillon vlerësimi me notë.

Mësuesi e vlerëson nxënësin nëpërmjet një sërë mënyrash dhe testimi (i pjesshëm ose përfundimtar) është vetëm njëra prej tyre. Testet të formulohen të tilla që të matim me objektivitet shkallën e përvetësimin të njohurive nga nxënësit. Për nxënësin e klasës së tretë mënyra të tjera vlerësimi janë po aq të frytshme sa edhe testet.

Mësuesi mund ta vlerësojë nxënësin në proces, çdo ditë, kur ai punon në mënyrë të pavarur (në klasë ose në shtëpi), vetëm ose në grup, kur nxënësi pyet, kur qorton shokun ose veten.

Kritere për hartimin e tekstit të matematikës për klasën e tretë të arsimit 9-vjecar

1. Parime të përgjithshme

Teksti shkollor ka qenë dhe vazhdon të jetë instrumenti më efektiv i procesit mësimor. Hartimi i tekstit bazë dhe fletëve të punës është proces, kërkon që në të gjitha etapat e tij:

- Të bazohet dhe të jetë në koherencë të plotë me paketën zyrtare të lëndës shkollore dhe, në veçanti, me programin e reformuar dhe standardet lëndore.
- Ta konsiderojë përvojën e deritanishme të shkollës sonë dhe përvojat pozitive të vendeve të tjera.
- Të mbështetet në përvojat e praktikës së drejtpërdrejtë shkollore duke përdorur metoda të ndryshme për tërheqjen e mendimit të këtij niveli.
- Të vlerësojë shkallën aktuale të zhvillimit të shoqërisë shqiptare dhe, në përshtatje me moshën e nxënësve, të pasqyrojë edhe dukuritë e reja sociale që lidhen me jetën e tyre.
- Të respektojë veçoritë e zhvillimit mendor dhe fizik të fëmijës 8-9-vjecar.
- Të synojë të luajë rol nxitës për ide novatore në mësimdhënien dhe mësimnxënien e matematikës.
- Të synojë në përfitimin e njohurive shkencore e shprehive edhe si rezultat të aftësive të caktuara, si edhe në edukimin e atyre qëndrimeve e vlerave të cilat hedhin themelet e profilit të qytetarit të ardhshëm të një shoqërie demokratike.
- Të synojë realizimin e një dokumenti me karakter fleksibël, duke i lënë vend mësuesit për zhvillime krijuese si në përmbajtje, ashtu edhe nga ana metodike

2. Krite shkencore e didaktike

- Për hartimin e teksteve bazë grupet e autorëve të mbajnë parasysh parashtrimet e pikave **5,6,7, 8** të programit të matematikës për klasën e tretë.
- Sasia e koncepteve matematike dhe e shprehive përkatëse të trajtuara në tekst, të jetë e njëjtë me ato të parashtruara në programin e matematikës në pikën **4**.
- Koncepti i numrit dhe i veprimeve me numra të zërë pjesën më të madhe të trajtimeve në tekst. Gjithsesi, trajtimet e koncepteve është mirë të bëhen të nderthurrura pavarësisht nga linja të cilës i përkasin.
- Teksti i nxënësit dhe fletët e punës përbëjnë dokumentacionin bazë mbi të cilin ndërtohet mësimi i matematikës. Si të tilla, ato të konceptohen tënjësuar dhe plotësuese të njëra-tjetrës.
- Fjala e shkruar të zërë më tepër vend se në tekstet paraardhëse.
- Informacioni në shërbim të koncepteve të jepet nëpërmjet fjalës së shkruar dhe ilustrimeve me ngjyra (skica, piktura).
- Ilustrimet, si pjesë e tekstit ose fletëve të punës, të mbushen me elemente nga mjedisi i njohur i nxënësit, pa përjashtuar edhe forma më abstrakte, të cilat ndihmojnë në përpunimin e mëtejshëm të konceptit.
- Të mënjanohet përdorimi i shablloneve që thjesht duhen imituar dhe që pengojnë zhvillimin e të menduarit të pavarur e krijues.

- Teksti i matematikës për klasën e tretë dhe fletët e punës të konceptohen si mjete pune për nxënësin dhe të hartohen në mënyrë të tillë që ai të bashkëpunojë me kënaqësi me to.
- Formimi i koncepteve të realizohet në përputhje me veçoritë e zhvillimit mendor të moshës së nxënësve të klasës së tretë duke ruajtur një raport të përshtatshëm të intuitives me logjiken.
- Konceptet e shprehite të ngrihen mbi *përvojën reale* të nxënësve, duke përdorur elemente me të cilat nxënësi është i familjarizuar.
- Larmia e detyrave në tekst dhe fletë pune të jetë e tillë që t'i japë mundësi çdo nxënësi të zgjedhë dhe të gëzojë *suksesin e tij në matematikë*.
- Përmasa e trajtimeve konceptuale t'i lerë hapësirat e nevojshme mësuesit për zhvillime krijuese si në përmbajtje, ashtu edhe nga ana metodike.
- Përdorimi i ngjyrave dhe i kontrasteve të ketë parasysh të mos dëmtojë shëndetin e nxënësve.
- Informacioni nëpërmjet fjalës së shkruar, përfshirë edhe simbolikën matematike, të përbëhet nga fjalë dhe fjali të qarta.
- Fletët e punës të vlerësohen si material bazë mbi modelin e të cilave mësuesi mund të pasurojë më tej punën e tij me nxënësit.

Teksti i nxënësit 170 A4

Teksti i fletëve të punës 80 A4

Me katër ngjyra

Formati 210 x 300 mm